

VENDIM
Nr.436, datë 8.4.2008

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.862, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES”, SHA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, dhe të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.862, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 5 shtohen:

“... me përjashtim të pjesës së detyrimeve, që lidhen me huatë/kreditë afatgjata nga donatorët e huaj, që janë, disbursuar dhe materializuar, dhe që do të materializohen në të ardhmen si pjesë e aseteve të OSSH sha-së, në kuadër dhe në zbatim të projekteve e të marrëveshjeve përkatëse me kreditorët e huaj, sipas të cilave KESH sh.a.-ja do të mbetet në rolin e kredimarrësit ose të nënkredimarrësit, kur kredimarrëse është qeveria.”.

2. Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 e 5/2, me këtë përmbajtje:

“5/1 Asetet në administrim të KESH sh.a.-së, që i kalojnë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), sha, të regjistrohen në pronësi të këtij operatori.

5/2. Pronësia e aksioneve të OSSH sh.a.-së, transferohet nga KESH sh.a.-ja, te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha